



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400983/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda : *Rekomandohet marrja e nismës për ndryshim në legjislacion*

Drejtuar : **Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**
Komisioni i ligjeve.

Ministrit të Drejtësisë
Z.Nasip Naço

TIRANE

I nderuar Kryetar i Kuvendit!

I nderuar Z.Ministër!

Institucioni i Avokatit të Popullit në procesin e shqyrtimit të çështjes së prezantuar prej shtetasit K.B., vlerëson se, parashikimi i kryer në nenin 45 të ligjit nr.122/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, date 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", se :

"Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit",

vjen në kundërshtim me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar nën nenin 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe barazisë para ligjit.

Rënia e masës së pezullimit të veprimeve përmbarimore në afatin e vendosur në dispozitën ligjore të sipërcituar, vetëm në rastin e kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e aktit të dhënies së kredisë bankare apo aktit për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare, dhe jo për gjithë llojet e titujve ekzekutiv për të

cilat Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor është ngarkuar me ligj për ekzekutimin e detyrueshëm të tyre, nuk i vendos subjektet e interesuara për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të ndryshëm nga ai përcaktuar në nenin 45 të Ligjit nr.122/2013, në pozitë të barabartë para ligjit me subjektet e interesuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, akt dhënie kredie bankare. Kufizimi i rënies së masës të pezullimit të veprimeve përmbarrimore vetëm në rastin e kryerjes së veprimeve përmbarrimore për ekzekutimin e aktit të dhënies së kredisë, dhe jo për gjithë llojet e titujve ekzekutiv, shkel të drejtën e zhvillimit të procesit të ekzekutimit, për të gjithë llojet e titujve ekzekutiv, sipas të njëjtës procedurë. Sipas sanksionimit të kryer në nenin 17 të Kushtetutës së RSH, kufizimi i vendosur në dispozitën ligjore, neni 45 i Ligjit nr.122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, do të justifikohet në rast se do t’i shërbente një interesi publik të gjerë dhe jo vetëm disa subjekteve kredidhënës siç parashikon dispozita ligjore në fjalë.

Rënia nga fuqia e një vendimi gjyqësor, të përkohshëm, për sigurimin e objektit të padisë sipas të cilit është vendosur për pezullimin e veprimeve përmbarrimore ndodh në rastet e parashikuara në nenin 211 të Kodit të Procedurës Civile. Parashikimi i kryer në nenin 45 të Ligjit nr.122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, se masa e sigurimit të padisë për pezullimin e veprimeve përmbarrimore në rastin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, akt dhënie kredie, bie pas kalimit të afatit prej 20 ditësh nga vendosja, passjell zhvillimin e procedurës së gjykimit në cënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Çfarë ndodh nëse shqyrtimi i padisë dhe marrja formë të prerë të vendimit gjyqësor nuk kryhet brenda 20 ditëve? A do të mund gjykata të rivendos të njëjtën masë sigurimi me rastin e përfundimit të afatit 20 ditor të dhënies së vendimit gjyqësor të përkohshëm si dhe ngritjes së padisë në afatin e vendosur në nenin 204 të K.Pr.Civile? Sipas parashikimit të kryer në nenin 204 të K.Pr.Civile, brenda 15 ditëve nga data e dhënies së vendimit për sigurimin e objektit të padisë, pra pezullimit të veprimeve përmbarrimore, duhet të ngrihet padia. Ngritja e padisë brenda këtij afati bënë të mundur vijimin e efekteve të masës së sigurimit deri në përfundim të gjykimit të padisë apo deri në revokimin e mundshëm të saj nga gjykata, sipas nenit 207, 211 të K.Pr.C. Respektimi i parashikimit për rënien e masës së sigurimit të padisë sikurse parashikuar në nenin 207, 2011, nuk mund të kryhet në rastin e pezullimit të veprimeve përmbarrimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, akt dhënie kredie, për shkak se afati i qënies në fuqi të saj është vetëm 20 ditë sipas nenit 45 të Ligjit nr.122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”. Sipas parimit të “Gjësë së gjykuar” nuk mund të ndodh që gjykata të rimarr në shqyrtim të njëjtën kërkesë të palës për vendosjen e së njëjtës masë të sigurimit të objektit të padisë, pra të pezullimit të veprimeve përmbarrimore. Atëhere, a do mund të flitet për sigurimin e të drejtave të paditësit me rastin e rënies nga fuqia të vendimit gjyqësor të përkohshëm pas 20 ditëve të dhënies së tij. Kuptohet se jo.

Në rast se pala paditëse do të bëj të mundur ngritjen e padisë në ditën e pesëmbëdhjet sipas parashikimit të nenit 204 të K.Pr.Civile, atëhere masa e sigurimit të padisë do të prodhojë efekte vetëm për pesë ditë gjatë gjykimit të padisë. Gjykimi i padisë brenda pesë ditëve si dhe marrja formë e prerë e vendimit gjyqësor përfundimtar brenda këtij afati nuk është i parashikuar në asnjë dispozitë ligjore në fuqi. Në këto kushte,

ekzekutimi i vendimit për të drejtën e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Në këtë situatë ligjore nuk mund të flitet për garanci në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor sikurse sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Bazuar në parashikimet e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 24 të Ligjit nr. 8454, date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, se: “ Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisë për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë : a) t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin e përmirësimin e ligjeve...

REKOMANDOJMË

Marrjen e nismës për ndryshimin e dispozitës ligjore neni 45 i Ligjit nr.122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konceptoi dhe Daktilografoi

A.Gjoleka